



Përmbushja e “Kartës së Zotimeve” nga dhjetë kryetarët e komunave

Dhjetor, 2022

-  Graçanicë
-  Kamenicë
-  Mitrovicë e Jugut
-  Obiliq
-  Prizren
-  Istog
-  Lipjan
-  Pejë
-  Skënderaj
-  Mitrovicë e Veriut



Përmbushja e “Kartës së Zotimeve” nga dhjetë kryetarët e komunave

Dhjetor, 2022



Visit our website
www.dplus.org

Zbuloni më shumë për publikimin tonë të fundit,
lajmet, infografikat online.



Na gjeni në Facebook
[@democracyplus](https://www.facebook.com/democracyplus)



Na gjeni në LinkedIn
[@democracy-plus](https://www.linkedin.com/company/democracy-plus)



Na gjeni në Twitter
[@democracy_plus](https://twitter.com/democracy_plus)



Na gjeni në Youtube
[@Democracy Plus](https://www.youtube.com/DemocracyPlus)

Zyret tona:

Rruga Bajram Kelmendi, Nr.92, Kati V
Prishtinë, 10000
Kosovë

+383 (0) 38 749 288
info@dplus.org

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet ose transmetohet në çfarëdo forme ose me ndonjë mjet elektronik, mekanik, fotokopjues ose tjera, pa lejen e D+.

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Olof Palme International Center (OPC). Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e D+ dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.



Aleanca
për Qytetari
Aktive



SWEDEN

Përmbajtja

Hyrje	6
Metodologjia	7
Përmbledhje e përgjithshme e përmbushjes së zotimeve në komuna	8
Komuna e Graçanicës	11
Komuna e Istogut.....	19
Komuna e Kamenicës.....	23
Komuna e Lipjanit.....	29
Komuna e Mitrovicës së Jugut	35
Komuna e Mitrovicës Veriore	43
Komuna e Obiliqit	49
Komuna e Pejës	57
Komuna e Prizrenit.....	63
Komuna e Skenderajt.....	69

Hyrje

Për qytetarët, komuna është institucioni i parë të cilit i drejtohen për të ngritur problemet që i preokupojnë, si dhe për të kërkuar adresimin e kërkesave të tyre. Përderisa procesi i paraqitjes të kërkesave dhe marrjes të përgjigjes nga institucionet lokale rregullohen me legjislacion të veçantë, komunikimi i shëndoshë mes autoriteteve lokale dhe qytetarëve qëndron në zbatimin e praktikave demokratike të cilat jo medoemos janë obligime ligjore.

Meqë shoqëria kosovare synon të jetë shoqëri demokratike, atëherë përtej plotësimit të kërkesave ligjore, duhet të krijohet hapësirë për zhvillimin dhe inicimin e këtyre praktikave, që në forma të ndryshme garantojnë gjithëpërfshirje, barazi dhe dialog të frytshëm social.

Që nga paslufta, në Kosovë janë mbajtur shtatë palë zgjedhje lokale. Ajo çfarë ka vazhduar të jetë konsistente përgjatë këtyre proceseve zgjedhore është se kandidatët politikë, qoftë për kryetar të komunës apo për anëtarë të kuvendit të komunës, kanë garuar pa prezantuar program politik të qartë. Në raste kur partitë politike kanë paraqitur programe politike për katër vite qeverisje, këto programe janë hartuar pa u harmonizuar me kërkesat dhe nevojat faktike të qytetarëve dhe shpesh herë qytetarët kanë mbetur pa zgjedhje adekuate. Kështu, qytetarët janë ballafaquar me një situatë në të cilën ata janë detyruar t'i përshtatin prioritetet e tyre ndaj programeve politike, dhe jo anasjelltas.

Për të adresuar këtë problem, *Aleanca për Qytetari Aktive* përgjatë vitit 2021 ka bërë identifikimin e prioriteteve qytetare para zgjedhjeve lokale, dhe njëkohësisht ka monitoruar përbushjen e tyre gjatë vitit vijues.

Metodologjia

Monitorimi i përmbushjes së zotimeve zgjedhore të kryetarëve të komunave është iniciativë e nëntë organizatave të shoqërisë civile në Kosovë, që veprojnë në kuadër të koalicionit “Aleanca për Qytetari Aktive”. Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore për kryetarë të komunave 2021, në dhjetë komuna të Kosovës janë organizuar tridhjetë tubime me qytetarë për të identifikuar kërkesat e tyre ndaj kandidatëve për kryetar të komunës së tyre. Nga tri tubime janë organizuar për secilën komunë. Në tubimin e parë është diskutuar për çështje të përgjithshme që preokupojnë qytetarët. Në tubimin e dytë është diskutuar për një temë specifike për secilën komunë, në varësi të asaj çfarë organizatat lokale e kanë konsideruar si më të nevojshme. Kurse tubimi i tretë ka pasur një temë të njëjtë për dhjetë komunat, ku është diskutuar për dialogun social.

Pas përfundimit të takimeve, kërkesat e qytetarëve janë mbledhur në një bazë të të dhënave dhe janë renditur sipas votave të marra gjatë diskutimeve. Kështu, janë identifikuar prioritetet e qytetarëve dhe kërkesat tjera më pak urgjente.

Për secilën komunë është hartuar dokumenti i veçantë i quajtur Karta e Zotimeve. Në Kartën e Zotimeve janë listuar të gjitha kërkesat e qytetarëve, të renditura sipas prioritetit dhe fushës që i takojnë. Karta e Zotimeve është hartuar me qëllim që t’u prezantohet kandidatëve për kryetarë komune. Të gjithë kandidatëve për kryetarë komune në dhjetë komunat e përzgjedhura u është ofruar mundësia që të nënshkruajnë këtë Kartë, e cila do të shërbejë si kontratë sociale mes tyre dhe qytetarëve të cilët ata do t’i qeverisin për katër vitet e ardhshme. Karta e Zotimeve njëkohësisht do t’i shërbejë shoqërisë civile si dokument bazë për të monitoruar qeverisjen lokale në katër vitet e ardhshme në këto dhjetë komuna.

Pas përfundimit të zgjedhjeve, organizatat anëtare të koalicionit “Aleanca për Qytetari Aktive” kanë takuar kryetarët e zgjedhur të komunave, për t’iu rikujtuar zotimet zgjedhore dhe avokuar për përmbushjen e tyre. Progresi në përmbushjen e zotimeve është duke u monitoruar në baza të rregullta nga organizatat dhe po prezantohet në platformën “zotimet.forumi.online”, ku ipet mundësia për qytetarët që të shohin përmbushjen e zotimeve.

Në këtë projekt që mbështetet nga Olof Palme International Center, të përfshira janë dhjetë komuna: Graçanicë, Istog, Kamenicë, Lipjan, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Obiliq, Pejë, Prizren dhe Skënderaj. Monitorimi i zotimeve bëhet nga këto organizata Reconciliation Empowering Communities (REC) në Mitrovicë të Jugut, Syri i Vizionit në Pejë dhe Istog, OJQ Fortesa në Kamenicë, Iniciativa Qytetare Skenderaj në Skënderaj, EC Ma Ndryshe në Prizren. Youth Association for Human Rights (YAHR) në Lipjan, Aktiv në Mitrovicë të Veriut, Communication For Social Development (CSD) në Graçanicë, dhe Democracy Plus (D+) në Obiliq.

Përmbledhje e përgjithshme e përmbushjes së zotimeve në komuna

Kryetarët aktual të dhjetë komunave janë zotuar për 227 kërkesa të qytetarëve. Prej tyre, gjatë vitit të parë të mandatit, janë përfunduar 34 apo 14.98%, në proces të përfundimit janë 110 apo 48.46%, ndërsa nuk ka pasur fare progres në 83 apo 36.56% zotime të bëra gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

Prioritetet e qytetarëve kryesisht kanë të bëjnë me disa fusha, si: sociale, infrastrukturore, administrative, të ambientit dhe të tjera. Kërkesat ndryshojnë nëpër komuna, megjithatë ndër shqetësimet kryesore mbeten papunësia e të rinjve dhe grave, mungesa e aftësisë profesionale, neglizhimi i zonave rurale nga institucionet lokale, mos respektimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, si dhe mungesa e prospektit për zhvillim. Pra, disa nga çështjet e ngritura në fushën sociale kanë përfshirë rritjen e numrit të çerdheve publike, nxitjen dhe përkrahjen e grave për punësim, ndarja e subvencioneve dhe të tjera. Nga gjithsej 61 kërkesa të kësaj fushe, gjatë këtij viti janë përfunduar vetëm 16%, në proces të përfundimit janë 46%, dhe për 38% të çështjeve ende nuk është ndërmarrë diçka konkrete.

Në fushën e infrastrukturës, çështjet për të cilat janë zotuar kryetarët e komunave janë menaxhimi i hapësirave publike, rregullimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, ndërtimi i pjerrinave si dhe padyshim, asfaltimi i rrugicave. Prej 39 zotimeve, 5 janë përfunduar, 24 janë në përfundim e sipër, si dhe 10 çështje të pashqyrtuara, por që pritet të adresohen gjatë viteve të ardhshme të qeverisjes.


Një kërkesë tjetër e qytetarëve në këto komuna, ka të bëjë edhe me punën e administratës. Në dhjetë komunat, qytetarët kanë kërkuar depolitizimin e proceseve të punësimit, respektivisht punësimin në bazë të meritës. Përveç kësaj, kryetarët janë zotuar edhe për digjitalizimin e shërbimeve komunale, eliminimin e burokracisë në komunë e çështje të ngjashme. Edhe pse kjo fushë është e treta për nga numri i kërkesave të qytetarëve, kryetarët nuk i kanë kushtuar edhe aq rëndësi. Nga gjithsej 31 zotime, vetëm 1 është përmbushur nga Komuna e Istogut, 15 janë në proces, dhe 15 të tjera ende nuk kanë filluar.


Në takimet me qytetarë gjatë fushatës zgjedhore, përveç problemeve të përgjithshme i është kushtuar një takim i veçantë çështjes së drejtësisë sociale, andaj rrjedhimisht kjo ka ndikuar që numri më i madh i kërkesave të jetë nga kjo fushë. Kështu që, duke lënë anash këtë fushë, numri më i madh i kërkesave është në lidhje me infrastrukturën. Dhjetë komunat gjatë vitit të parë të qeverisjes, kanë përmbushur 13% të këtyre kërkesave, 62% janë në proces të përfundimit dhe në 26% ende nuk ka progres.


Në anën tjetër, në fushën e ekonomisë është vetëm një kërkesë, e cila ende është në proces të përfundimit. Qytetarët kanë ngritur më së paku çështje edhe në fushën e urbanizimit, sportit e bujqësisë. Edhe pse numri i vogël i kërkesave, kryetarët nuk kanë përmbushur as 50% të tyre.


Më poshtë do të analizohet veç e veç secila komunë, për secilin zotim, në kategori të ndara në bazë të fushës së prioriteteve.

PËRMBUSHJA E ZOTIMEVE NË DHJETË KOMUNA

 Të përfunduara

 Në progres

 Nuk ka progres



Graçanicë



Istog



Kamenicë



Lipjan



Mitrovicë e Jugut



Pejë



Obiliq



Skënderqaj




Prizren



Mitrovicë e Veriut

PËRMBUSHJA E PËRGJITHSHME E ZOTIMEVE SIPAS FUSHAVE



Të përfunduara

Në progres

Nuk ka progres



 Plotësisht

 Pjesërisht

 Aspak

Në takimet e organizuara me qytetarët e Komunës së Graçanicës, është diskutuar për problemet e përgjithshme në komunë, për migrimin e të rinjve, dhe për dialogun social për punë të dinjitetshme për gra, burra dhe rini në nivel lokal. Në këto diskutime kanë marrë pjesë gjithsej 43 qytetarë, prej të cilëve 30% kanë qenë gra, dhe 70% kanë qenë burra.


Qytetarët kanë ngritur 32 prioritetet të cilat, sipas tyre, duhet të adresohen nga qeverisja e ardhshme lokale. Kryetarja e tanishme, Ljiljana Subariq është zotuar për 29 prej tyre.



Çështjet që i kanë ngritur qytetarët janë të fushës së ambientit, administratës, arsimit dhe të tjera si më poshtë:




Ambient

- 1** **Pastrimi i lumit dhe largimi i deponive ilegale në fshatin Shushicë, si dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbra** STATUSI:  Plotësisht

Është zgjidhur edhe pastrimi i deponive, mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbra.

- 2** **Zgjidhja e çështjes së ndotjes së lumit Graçanka** STATUSI:  Pjesërisht


Pastrimi i pjesshëm i lumit Graçanicë është bërë vetëm në fshatin Graçanicë. Problemi më i madh është në Llapnasellë dhe Preoc dhe do të jetë një proces i gjatë për të zgjidhur këtë problem dhe për të pastruar lumin në fshatrat Susicë, Gornja Gustericë, Dobratin dhe pjesërisht në fshatrat e Llapnasellës.

- 3** **Pastrimi i lumit dhe shtratit të lumit, si dhe largimi i deponive ilegale në fshatin Preoc** STATUSI:  Pjesërisht

Në deponitë e fshatit Preoc pastrohen mbeturinat, por problem është rikrijimi i mbetjeve të deponive të reja.

- 4** **Pastrimi i lumit dhe shtratit të lumit në fshatin Dobratin** STATUSI:  Pjesërisht


- 5** **Rehabilitimi i kanalit të lumit për shkak të përmytjeve në fshatin Gushtericë e Poshtme** STATUSI:  Pjesërisht

- 6** **Zgjidhja e problemit me llumin** STATUSI:  Aspak

- 7** **Largimi i deponive ilegale në fshatin Dobratin** STATUSI:  Aspak




Administratë

- 8** Përmirësimi i funksionalitetit të departamentit për zhvillimin ekonomik, si dhe zhvillimi i pabarabartë STATUSI:  Pjesërisht

Departamenti është funksional, kanë shumë projekte, por ende nuk kanë mjaftueshëm punësim për të mbuluar të gjitha aktivitetet që duhet të bëjnë.

- 9** Përmirësimi i funksionalitetit të Kuvendit Komunal. STATUSI:  Pjesërisht


- 10** Përmirësimi i komunikimit midis vetëqeverisjes lokale dhe institucioneve qendrore STATUSI:  Aspak

- 11** Zvogëlimi i ndikimit politik tek punëtorët STATUSI:  Aspak


- 12** Përkufizimi i qartë i roleve, detyrimeve dhe të drejtave në kontratat e punës STATUSI:  Aspak



Arsim

- 13** Rritja e numrit të objekteve shkollore për shkak të të cilave mësimet zhvillohen në tri ndërrime, gjë që ndikon në cilësinë e arsimit STATUSI:  Plotësisht

U hap një qendër e shkollës së mesme dhe shkollat fillore tani janë funksionale pjesërisht.

- 14** Përmirësimi i cilësisë së arsimit përmes ndërtimit të disa objekteve shkollore për mësimdhënie adekuate (mësimet ndiqen në tri ndërrime për shkak të mungesës së objekteve për të gjitha shkollat) STATUSI:  Plotësisht

U hap një qendër e shkollës së mesme dhe shkollat fillore tani janë funksionale pjesërisht.



Arsim

15

**Krijimi i institucioneve për arsim të lartë/
departamenteve të arsimit**

STATUSI:  Aspak

Edhe pse Ligji për Vetëqeverisje Lokale, te kompetencat e zgjeruara, përcakton se është kompetencë e komunave me shumicë serbe, Komuna e Graçanicës nuk ka ndërmarrë diçka për këtë çështje.



Sociale

16

Krijimi i hartës sociale të popullsisë

STATUSI:  Aspak

17

Zvogëlimi i ndikimit politik tek të rinjtë

STATUSI:  Aspak

18

**Ndryshimi i qasjes së të rinjve me qëllim të
krijimit të besimit në institucione**

STATUSI:  Aspak

19

**Rritja e numrit të punëtorëve nga grupi i
personave të margjinalizuar.**

STATUSI:  Aspak

Infrastrukturë

20

Rregullimi i kanalizimit në fshatin Dobratin

STATUSI:  Plotësisht

Është rregulluar kanalizimi në këtë fshat, gjithashtu edhe në fshatin Preoc dhe Badovc.

21

**Rregullimi i rrugëve dhe trotuareve në
territorin e të gjithë komunës**

STATUSI:  Pjesërisht

Komuna në dy muajt e fundit po punon vazhdimisht për rikonstruksionin dhe asfaltimin e rrugëve.



Infrastrukturë

22

Zgjidhja e çështjes së furnizimit me ujë në fshatin Shushicë

STATUSI:  Aspak

Komuna në dy muajt e fundit po punon vazhdimisht për rikonstruksionin dhe asfaltimin e rrugëve.



Siguri

23

Komunikim më i mirë me stacionin policor në Graçanicë për të përmirësuar gjendjen e sigurisë në territorin e komunës

STATUSI:  Pjesërisht

Bashkëpunim më i mirë ndërmjet përfaqësuesve komunalë dhe stacionit policor se sa vitin e kaluar.

24

Komunikim më i mirë i vetëqeverisjes lokale me stacionin policor lokal në mënyrë që të përmirësohet gjendja e sigurisë në të gjitha fshatrat në territorin e komunës

STATUSI:  Pjesërisht

Kanë komunikim më të mirë.



Shëndetësi

25

Ndërtimi i spitalit

STATUSI:  Aspak

Transport

26

Zgjidhja e çështjes së mungesës së transportit publik në territorin e komunës

STATUSI:  Aspak



Sport

27

Investim më i madh në aktivitetet sportive, aktivizim dhe ndihmë për klubet që punojnë me të rinjtë

STATUSI:  Plotësisht

Departamenti për sport dhe rini mbështet të gjitha klubet sportive në territorin e komunës.



Kulturë

28

Investime më të mëdha në ngjarje kulturore dhe aktivitete të ndryshme kulturore

STATUSI:  Plotësisht

Komuna këtë vit ka investuar më shumë se vitin e kaluar në aktivitete që promovojnë kulturën. Janë shumë më të mirë në këtë fushë.



 Plotësisht

 Pjesërisht

 Aspak

Në Komunën e Istogut janë organizuar tri diskutime me qytetarë. Në debatin e parë është diskutuar për problemet e përgjithshme, në të dytin për mbështetjen e sektorit të bujqësisë, dhe në të tretin për dialogun social për punë të dinjitetshme për gra, burra dhe rini në nivel lokal. Në këto tri diskutime kanë marrë pjesë gjithsej 40 qytetarë, prej të cilëve 78% kanë qenë gra, dhe 9% kanë qenë burra.

Nga 20 prioritetet që janë ngritur nga qytetarët, kandidati i atëhershëm, Ilir Ferati nga Lidhja Demokratike e Kosovës, që tani është kryetar i Komunës, është zotuar për 5 prej tyre. Zotimet janë të fushës sociale, turizmit, bujqësisë dhe administratës.



Çështjet që i kanë ngritur qytetarët janë të fushës së turizmit, bujqësisë, administratës dhe të tjera si më poshtë:



Turizëm

1 Zhvillimi i turizmit malor

STATUSI:  Plotësisht

Për këtë çështje, është kërkuar hartimi i strategjisë për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit, nxitja e turizmit malor përmes identifikimit dhe dhënies në shfrytëzim të pronave komunale në Bjeshkët e Istogut, investimi potencial në ngritjen e kapaciteteve akomoduese, shenjëzimi i të gjitha shtigjeve për hiking dhe rrugëve malore. Gjithashtu është kërkuar edhe ndërtimi i tri pikave për kamping dhe pesë pushimoreve për turist, konform standardeve evropiane të bjeshkëtarisë.

Në planifikimet buxhetore për vitin 2023, është paraparë ndërtimi i “Via Ferrata” në Mokën. Për këtë projekt janë planifikuar 25,000.00 euro.



Bujqësi

2 Ndërtimi i kanaleve të ujitjes për tokat bujqësore

STATUSI:  Pjesërisht

Për këtë çështje, komuna ka theksuar se janë në procedurë të prokurimit 10 kanale për ujitjen e tokave bujqësore. Gjithashtu, në planifikimet e kornizës afatmesme buxhetore për vitet 2023-2025 janë paraparë mjete përgjatë viteve planifikuese të buxhetit për ndërtimin e kanale të ujitjes në disa fshatra.

3 Furnizimi me llaktofriz dhe makina mbjellëse për fermat e lopëve

STATUSI:  Aspak

Në mungesë të mjeteve financiare këtë vit, komuna ka planifikuar 60,000.00 euro për vitin 2023 për mbështetjen e fermerëve me llaktofriza.



Administratë

4 Depolitizimi i proceseve të punësimit

STATUSI:  Plotësisht

Depolitizimi në komunë, vazhdon të jetë temë shqetësuese e qytetarëve të çdo komune. Në mënyrë që të rritet besimi i institucioneve lokale tek qytetarët, komuna ka parë të nevojshme angazhimin e ekspertëve të jashtëm. Këta ekspertë, do të ndihmojnë në depolitizimin e proceseve të punësimit dhe Ligji nr. 06/L-114 për zyrtarët publik, në bazë të së cilit, procedurat e punësimit janë detyra ekskluzive të Shefit të Personelit në Komunë.




Sociale

5 Ndërtimi i kopshteve ditore për fëmijë

STATUSI:  Pjesërisht

Një çerdhe është në ndërtim e sipër në qytetin e Istogut, e cila do të plotësoj në masë të madhe kërkesën e komuniteteve në këtë Komunë.



 Plotësisht

 Pjesërisht

 Aspak

Gjatë takimeve me qytetarët e kësaj komune, u diskutua për problemet e përgjithshme, për funksionalizimin e Këshillave Lokale, dhe për dialogun social për punë të dinjitetshme për gra, burra dhe rini në nivel lokal. Në këto tri diskutime kanë marrë pjesë gjithsej 43 qytetarë, prej të cilëve 42% kanë qenë gra, dhe 58% kanë qenë burra.

Në këto takime, qytetarët kanë ngritur 22 prioritete. Kryetari i tanishëm, Kadri Rahimaj nga Lëvizja Vetëvendosje është zotuar për 21 prej tyre. Zotimet përfshijnë çështje të fushës së administratës, sociale, inspektoratit e të tjera. Në fushën e administratës, qytetarët kanë ngritur më së shumti çështje për të cilat Kryetari është zotuar. Megjithatë, nga monitorimi i përmbushjes së prioriteteve nga fusha e administratës, asnjëri prej tyre ende nuk është përmbushur plotësisht.



Çështjet që i kanë ngritur qytetarët janë të fushës së administratës, inspektoratit, arsimit dhe të tjera si më poshtë:



Administratë

1 Rritja e kompetencave të bashkësive lokale STATUSI: Pjesërisht

Ndryshimi i rregullores është bërë, por më shumë kompetenca kryetarëve nuk u janë dhënë.

2 Rritja e bashkëpunimit në mes të organeve komunale dhe këshillave lokale STATUSI: Pjesërisht

Deri më tani Kryetari i komunës, e ka mbajtur një takim me krerët e bashkësive lokale.

3 Zbatimi i Ligjit të Punës në nivel komunal STATUSI: Pjesërisht

Gjatë monitorimit të punës së Komunës, ende nuk është parë një iniciativë e mirëfilltë e organeve komunale në këtë drejtim.

4 Avokimi në nivel qendror për të angazhuar Noter në komunë STATUSI: Aspak


Prej më shumë se tre vitesh, Komuna e Kamenicës është pa noter. Publikisht nuk është parë një iniciativë e kryetarit të Komunës që ta sensibilizojë këtë problem.

5 Funkcionalizimi i një zyre për nevojat e këshillave STATUSI: Aspak

Aktualisht, Këshillat Lokale nuk e kanë një zyre brenda institucioneve, edhe pse Komuna është zotuar për funksionalizimin e një zyre të tillë.



Administratë

- 6** **Mbajtja e takimeve mujore në mes të kryetarit të komunës dhe udhëheqësve të këshillave lokale** STATUSI:  Aspak

Nga marrja e mandatit të kryetarit, deri në Nëntor të këtij viti, është mbajtur vetëm një takim në mes të kryetarit dhe përfaqësuesve të këshillave lokal.

- 7** **Rritja e përgjegjësisë së drejtuesve të Këshillat Lokale** STATUSI:  Aspak

Një rregullore është ndryshuar, miratuar në një nga seancat e Asamblesë Komunale, e bartur nga ish-udhëheqja Komunale, por që nuk iu jep asnjë përgjegjësi më tepër drejtuesve të Këshillave Lokale.

- 8** **Digjitalizimi i shërbimeve komunale për qytetarët** STATUSI:  Aspak


Një e-kiosk i vendosur gjatë vitit 2021 (në mandatin e qeverisjes së kaluar komunale), është larguar. Një e-kiosk është funksionale në hyrje të ndërtesës së Komunës së Kamenicës. Mund të vlerësojmë se përparim tjetër në këtë drejtim s'ka pasur)



Sociale

- 9** **Hartimi i Strategjisë për rritje të punësimit të grave** STATUSI:  Plotësisht

Më shumë se gjysma e drejtorëve janë gra, poashtu edhe në komisione pjesëmarrja e tyre është e kënaqshme.

- 10** **Përfshirja më e madhe e grave në komisione dhe organe vendimmarrëse të komunës** STATUSI:  Pjesërisht

Në zgjedhjet e mbajtura para pak javësh janë zgjedhur disa gra në kryesitë e KL-ve, por asnjë grua si kryetare e organit.



Sociale

11

Zbatimi i kontratave kolektive në nivel komunal

STATUSI:  Pjesërisht

Një kontratë kolektive e nënshkruar në mandatin e qeverisjes së kaluar, nga kryetari i Komunës, SBASHK-u është duke e zbatuar.

12

Eliminimi i diskriminimit në punësim për personat me aftësi të kufizuara

STATUSI:  Aspak

Për këtë çështje, nuk është dërmarrë një iniciativë e tillë, ndërsa gjatë këtyre muajve nuk është punësuar asnjë person me aftësi të kufizuara.

13

Nxitja e grave për të udhëhequr me Këshillat Lokale

STATUSI:  Aspak

Më shumë se gjysma e drejtorëve janë gra, poashtu edhe në komisione pjesëmarrja e tyre është e kënaqshme. Gjysma e posteve në udhëheqjen e kaluar komunale kanë qenë gra. Edhe në këtë mandat, prej 11 drejtorive 6 nga to drejtohen nga gratë. Poashtu edhe nënkryetarja për komunitete nga radhët e pakicës serbe, është një grua. Ndërsa, në Komitete Konsultative që veprojnë si organizma të Kuvendit Komunal, rreth 40 % e tyre janë gra.

14

Organizimi i kampanjave për vetëdijesimin e punëtorëve për të drejtat e tyre

STATUSI:  Aspak

Gjatë këtij viti, nuk kemi arritur të shohim asnjë iniciativë apo fushatë për vetëdijesimin e punëtorëve për të drejtat e tyre. Përkundrazi, kemi vërejtur një presion kur ishin aktive gratë në shërbimin civil dhe ato në arsim.

15

Hartimi i Strategjisë për ulje të emigrimit të të rinjve

STATUSI:  Aspak

Nuk ka pasur asnjë iniciativë të tillë. Kamenica, krahasuar me komunat e tjera, në bazë dhe të statistikave zyrtare qëndron keq në këtë drejtim. Shumë qytetarë, kryesisht të rinj, në këto vitet e fundit kanë emigruar, duke u larguar për në vendet perëndimore, ose edhe në qytete të tjera



Inspektorat

16 Zbatimi i Rregullores kundër ndotjes akustike STATUSI: Plotësisht

Gjatë sezonit të verës, është respektuar rregullorja, pasi ka pasur inspektime të shpeshta në qytet. Inspektimi është bërë nga ana e Inspektoratit të Komunës dhe Policisë së Kosovës. Gjatë kësaj vere, Inspektorati nuk ka shqiptuar asnjë gjobë. Por, gjrobat janë shqiptuar nga Policia e Kosovës. Numri i tyre ka qenë 10, kryesisht për tejkalim të kohës (deri në orën 23:00 gjatë verës), sa ka qenë koha e lejuar për muzikë.

17 Rritja e kapaciteteve të komunës për inspektim të punës STATUSI: Aspak

Më tepër është kompetencë e nivelit qendror.



Arsim

18 Orientimi i shkollave profesionale në drejtim të ndërlidhjes me nevojat e tregut të punës STATUSI: Pjesërisht

Për këtë çështje është ndërtuar një shkollë e re profesionale në Kamenicë. Në Nëntor të këtij viti, është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit në mes të shkollës profesionale “Andrea Durrsaku” dhe drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik. Qëllimi i marrëveshjes është krijimi i mundësive për nxënësit për të aplikuar njohuritë e tyre dhe njëkohësisht për të siguruar përfitime për punëdhënësit nga sektorët përkatës duke rekrutuar punëtorë të mundshëm me kosto të arsyeshme.



Infrastrukturë

19 Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm STATUSI: Pjesërisht

Është shpuar një pus në një lagje të qytetit, e cila do të ndikojë në përmirësimin me furnizim me ujë të qytetit, që është një problem i madh, sidomos gjatë verës.



Ambient

20 Trajtimi i mbeturinave të ngurta

STATUSI:  Aspak

Kamenica nuk e ka asnjë deponi për trajtimin e mbeturinave. Ato hidhen në dy lokacione që shpeshherë shkaktojnë kundërmime dhe përbëjnë shqetësim për banorët. Një lokacion i planifikuar për në vendin e quajtur "Te Rovinat" nuk është në harmoni me planin zhvillimor komunal. Komuna nuk ka arritur ta shfuqizojë vendimin për ndryshimin e lokacionit, sepse nuk ka pasur propozim konkret për caktimin e lokacionit të ri. As për vitin e ardhshëm nuk ka një propozim për zgjidhjen e këtij problemi.



Siguri

21 Rritje të investimeve në brezin kufitar, në fokus Karaçeva

STATUSI:  Pjesërisht

Ka nisur asfaltimi i disa rrugëve lokale në këtë fshat.



 Plotësisht

 Pjesërisht

 Aspak

Në Komunën e Lipjanit, gjatë fushatës zgjedhore janë organizuar tri diskutime me qytetarë. Në dy debatet e para është diskutuar për problemet e përgjithshme, ndërsa në të tretin për Dialogun social për punë të dinjitetshme për gra, burra dhe rini në nivel lokal. Në këto tri diskutime kanë marrë pjesë gjithsej 34 qytetarë, prej të cilëve 44% kanë qenë gra, dhe 56% kanë qenë burra.

Nga tri diskutimet, qytetarët kanë ngritur 26 prioritetet të cilat, sipas tyre, duhet të adresohen nga qeverisja e ardhshme lokale. Kryetari i tanishëm, Imri Ahmeti nga Lidhja Demokratike e Kosovës, është zotuar për 25 prej tyre.

Çështjet që i kanë ngritur qytetarët janë të fushës së infrastrukturës, kulturës, arsimit dhe të tjera si më poshtë:



Sociale

- 1 Përkrahje nga komuna për projekte individuale** STATUSI:  Plotësisht

Përkrahje me anë subvencionimit të tyre nga ana e drejtorisë komunale për Rini, Sport dhe Kulturë, si dhe nga Zyra e Kryetarit.

- 2 Organizimi i aktiviteteve për nxitje të aktivizimit të të rinjve** STATUSI:  Plotësisht


Janë mbajtur manifestime të ndryshme me karakter garues: Festivali i këngës për fëmijë, ditët e diasporës dhe gara nga shkollat.

- 3 Hapja e çerdheve të reja në zonat rurale** STATUSI:  Plotësisht

Janë ndërtuar çerdhet në fshatin Gadime, Sllovi dhe në Shalë.

- 4 Krijimi i programeve për orientim në karrierë** STATUSI:  Plotësisht

Janë realizuar në kuadër të Planit Të Veprimit Rinor Komunal.

- 5 Mundësimi i praktikës për nxënës të shkollave të mesme në institucione publike dhe private** STATUSI:  Pjesërisht

Janë pranuar 32 praktikantë me pagesë.

- 6 Ndarja e subvencioneve për organizatat rinore** STATUSI:  Pjesërisht

Është shpallur konkursi për subvencionim të OJQ-ve rinore.



Sociale

- 7** Zbatimi i Ligjit për Barazi Gjinore në punësime në komunë STATUSI: Pjesërisht

Ky ligj veçse është duke u zbatuar.

- 8** Nisja e dialogut social në nivel komunal STATUSI: Pjesërisht

Ka pasur takim të shoqërisë civile me zyrtar komunalë.

- 9** Identifikimi i nevojave të të rinjve në zonat rurale dhe të punohet në atë fushë STATUSI: Pjesërisht

Janë identifikuar në kuadër të Planit të Veprimit Rinor 2022/24.

- 10** Organizimi i kampanjave për siguri dhe shëndet në punë për të rinjtë dhe të rejtat STATUSI: Pjesërisht

Janë realizuar në kuadër të Planit Të Veprimit Rinor Komunal.

- 11** Subvencionimi i pagave për të rinjtë dhe të rejtat që hyjnë për herë të parë në tregun e punës STATUSI: Aspak



Infrastrukturë

- 12** Asfaltimi i rrugicave STATUSI: Plotësisht

Janë paraparë asfaltimi i rrugicave brenda fshatrave në kuadër të KAB 2022/25, por si proces i asfaltimit të rrugicave nëpër fshatra është i përfunduar.

- 13** Më shumë shtigje të biçikletave në qytet STATUSI: Pjesërisht

Janë ndërtuar shtigjet e ecjes në Lipjan, Gadime dhe janë planifikuar shtigje të tjera në kuadër të KAB 2023/25.



Infrastrukturë

14

Rregullimi i trotuareve në fshatin Kraishtë dhe Gadime

STATUSI:  Pjesërisht

Janë të përfshira në KAB 2022/25.

15

Funksionalizimi i ujësjellësit

STATUSI:  Pjesërisht

Mungesa e ujit nuk është kompetencë e komunës.



Kulturë

16

Rritja e buxhetit për Kulturë, Rini dhe Sport

STATUSI:  Plotësisht

Është rritur buxheti në investime kapitale, ndërsa në subvencione është i njëjtë në krahasim me vitin 2021.

17

Ndërtimi i shtëpisë së kulturës

STATUSI:  Pjesërisht

Kanë filluar procedurat dhe është përfshirë në KAB 2023/25.



Arsim

18

Rritja e numrit të bursave për studentët

STATUSI:  Plotësisht

120 bursa për student janë dhënë për vitin 2021 dhe 160 për vitin 2022 (40 bursa më shumë se të planifikuara).



Arsim

19

Ndarja e bursave për nxënësit e shkollave të mesme

STATUSI:  Pjesërisht

Drejtoria Komunale e Arsimit është duke bërë përpjekje rreth identifikimit të një kodi buxhetor për mundësinë e mbështetjes për vitin e ardhshëm.



Ambient

20

Rregullimi i shtratit të lumenjve

STATUSI:  Plotësisht

Është rregulluar shtrati i lumenjve në Komunën e Lipjanit dhe janë planifikuar edhe në kuadër të KAB 2022/25.

21

Krijimi i hapësirave të gjelbra nëpër fshatra

STATUSI:  Pjesërisht

Është paraparë rregullimi i parqeve në disa fshatra të komunës së Lipjanit gjatë 3 viteve të ardhshme.



Inspektorat

22

Krijimi i kontakteve në mes të komunës dhe këshillave të fshatrave për mbikëqyrjen e zbatimit të projekteve

STATUSI:  Pjesërisht

Është në proces rizgjedhja e Këshillave të Fshatrave dhe nga ana e kryetarit është kërkuar nga kryetarët e fshatrave të jenë aktiv në procesin e mbikëqyrjes së projekteve.

23

Avokimi në nivelin qendror për rritje të numrit të inspektorëve të punës në Lipjan

STATUSI:  Pjesërisht

Është drejtuar nivelit qendror me kërkesa nga ana e komunës së Lipjanit për rritjen e numrit të inspektorëve.



Administratë

24

Krijimi i një grupi mbikëqyrës të përbërë nga organizata të shoqërisë civile për konkurset publike

STATUSI:  Pjesërisht

Janë formuar komisione me pjesëmarrje të shoqërisë civile në të.




Transport

25

Ofrimi i transportit urban gjatë natës, me fokus në zonat rurale

STATUSI:  Aspak

Janë formuar komisione me pjesëmarrje të shoqërisë civile në të.



 Plotësisht

 Pjesërisht

 Aspak

Në Komunën e Mitrovicës së Jugut, në takimet me qytetarë, është diskutuar për problemet e përgjithshme në komunë, për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit, dhe për dialogun social për punë të dinjitetshme për gra, burra dhe rini në nivel lokal. Në këto tri diskutime kanë marrë pjesë gjithsej 32 qytetarë, prej të cilëve 34% kanë qenë gra, dhe 66% kanë qenë burra.

Nga tri diskutimet, qytetarët kanë ngritur 43 prioritetet të cilat, sipas tyre, duhet të adresohen nga qeverisja e ardhshme lokale. Kryetari i Komunës është zotuar për 33 prioritete.



Çështjet që i kanë ngritur qytetarët janë të fushës së ambientit, infrastrukturës, administratës dhe të tjera si më poshtë:



Sociale

1 Rritja e numrit të çerdheve publike STATUSI: Plotësisht

Situata e njëjtë, si në muajin paraprak. Në muajt paraprak, ka qenë pa çerdhe publike, qysh nga muaji Gusht. (Çerdhja publike ka filluar renovimin, dhe ende nuk ka përfunduar, as me 1 dhjetor siç ishte premtimi. Gjithashtu edhe dy çerdhet e reja në plan për tu ndërtuar, ende nuk janë përfunduar).

2 Rritja e punësimit të rinisë përmes krijimit të programit të orientimit në karrierë STATUSI: Pjesërisht

Në nëntor është shpallë konkursi te NP “Stacioni i Autobusëve” SH.A, Mitrovicë, për tri pozita, krye shef ekzekutiv, sekretar dhe zyrtar kryesor financiar.

3 Ndarje të buxhetit për ndërmarrje të vogla dhe të mesme, me fokus tek gratë ndërmarrëse STATUSI: Pjesërisht

Organizimi i Panairit të Punës për Bizneset Lokale (Organizuar nga Komuna e Mitrovicës në bashkëpunim me GlZ) - ku nga bizneset u ofruan 182 vende të lira pune.

4 Ndarja e bursave për studentët nga fushat që kanë më shumë kërkesë në tregun e punës STATUSI: Pjesërisht

Ndarja e 180 bursave për studentët e vitit akademik 2022/23, ku 10 prej tyre u takojnë komuniteteve dhe 50 prej tyre për nxënës të shkollës së mesme teknike “Arkitekt Sinani”.

5 Përfshirja e grave në treg të punës përmes buxhetit për ndërmarrje të vogla dhe të mesme dhe rritjes së numrit të çerdheve STATUSI: Pjesërisht

6 Ofrimi i qasjes për personat me aftësi të kufizuara në objektin e komunës dhe institucionet tjera publike STATUSI: Aspak

7 Mbështetja në marketing të qendrave për aftësim profesional dhe shkollat profesionale STATUSI: Aspak



Ambient

8 Mirëmbajtja e liqenit akumulues STATUSI: Plotësisht

Është bërë pastrimi dhe mirëmbajtja e drunjëve brigjeve të lumit tek liqeni akumulues.

9 Rregullimi i shtretërve të lumenjve STATUSI: Pjesërisht

Kompania Rajonale e Mirëmbajtjes “Uniteti” është institucion vartës i Drejtorisë së Mjedisit. Në detyrat e veta apo planin e punës, kompania në fjalë bënë rregullimin e shtratit të lumit “Trepça” sipas nevojës, si dhe mirëmbajtjen e shtratit të lumit “Lushta”, mirëpo pas të reshurave të cilat ndodhën gjatë këtyre muajve, duhej rregullim dhe pastrim i lumit “Lushta”, i cili veç kishte dalë nga shtrati i tij. Ndërsa, për lumin “Ibri” dhe “Sitnica” punimet për rregullimin e shtretërve të lumenjve është proces më i ndryshëm (me tenderim nga pushteti i kaluar) ku këto punime nuk janë aq të shpeshta.

10 Mbjellja dhe mirëmbajtja e fidanëve STATUSI: Pjesërisht

Kompania “Ambienti” vazhdon mirëmbajtjen dhe mbjelljen e hapësirave të gjelbëruara të kontraktuar nga Komuna e Mitrovicës. Gjithashtu është bërë mbjellja e 27 fidaneve tek liqeni akumulues (donacion nga kompania Twig).

11 Avancimi i riciklimit STATUSI: Pjesërisht

Komuna e Mitrovicës së Jugut, Komuna e Skenderajt dhe Komuna e Vushtrrisë, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për menaxhimin e mbeturinave.

12 Mirëmbajtje e pajisjeve të kompanisë për mirëmbajtje KRM “Uniteti” STATUSI: Pjesërisht

Është bërë shtrirja e rrjetit të kanalizimit në fshatin Shupkovc. Gjithashtu, po ndërtohen hapësirat e veçanta për vendosjen e kontenjerëve, nga Komuna dhe “Uniteti”.

13 Aplikimi i gjobave mandatorë për hedhjen e mbeturinave STATUSI: Aspak

Në Nëntor, Drejtorja e Inspekcionit ka gjobitë një qytetar që hodhi mbeturina në lumin Sitnica.



Infrastrukturë

14 Menaxhimi i hapësirave publike

STATUSI:  Pjesërisht

Komuna ka mbajtur disa diskutime publike për draft vlerësimi strategjik mjedisor i hartës zonale komunale 2020-2026; pastaj për draft rregulloren komunale për kriteret e vendosjes së objekteve të përkohshme në sipërfaqe dhe hapësira publike. Është bërë një investim 80 mijë euro për renovimin e sallës së edukatës fizike në shkollën fillore “Skënderbeu”. Gjithashtu është përfunduar renovimi i Shoqatës së Peshkatarëve tek Liqeni Akumulues në Mitrovicë me vlerë 212,716.00 euro.

15 Përmirësimi i infrastrukturës rrugore

STATUSI:  Pjesërisht

Gjatë monitorimit të punës së komunës është evidentuar se janë marrë disa masa si: kubëzimi i rrugës “Shala e Bajgorës” në fshatin Rekë, asfaltimi i rrugës Evlia Qelebia, përfundimi i Kubëzimit të rrugës së “Ulqinit” në Zhabar si dhe përmirësimi i infrastrukturës së rrugës “Mbretëresha Teutë” në qytetin e Mitrovicës.

16 Rregullimi i sistemit të kanalizimit

STATUSI:  Pjesërisht

Me iniciativë të komunës është bërë shtrirja e rrjetit të kanalizimit nga fshati Shupkocv, i cili i lidh rrjetet me fshatrat Kçiq i Vogël dhe fshatin Zasellë. Gjithashtu, ekzistojnë edhe plane tjera për rrjetin e kanalizimit tek komplekset e reja banesore të cilat janë në ndërtim e sipër, por ende nuk janë përfunduar.

17 Rritja e numri të parkingjeve dhe ndalimi i parkingut në trotuare

STATUSI:  Aspak

18 Rritja e shtypjes së ujit në ndërtesa kolektive

STATUSI:  Aspak




Administratë

19 Digjitalizimi i shërbimeve komunale për qytetarët STATUSI:  Pjesërisht

20 Punësimet në bazë të meritës STATUSI:  Pjesërisht

Kryesisht në departamentin e shëndetësisë, si dhe të arsimit ka pasur punësime, të cilat ishin në proces gjatë disa muajve. Ankesa në departament të shëndetësisë nuk ka pasur (mbase për shkak të mungesës së konkurrencës) kurse në departament të arsimit ka pasur ankesa dhe janë në proces. Arsyeja e vendosjes së statusit “pjesërisht” ishte për shkak të numrit jo të madh të punësimeve dhe se nuk mund të përcaktojmë procesin meritator për ato pozita.


21 Menaxhimi më i mirë e pasurive të komunës dhe krijimi i bazës së të dhënave të pronave të komunës STATUSI:  Aspak




Kulturë

22 Rritja e investimeve për zhvillimin e programeve kulturore STATUSI:  Pjesërisht

Gjatë vitit të parë të mandatit të kësaj qeverisjeje, janë mbajtur disa aktivitete kulturore si: aktiviteti “Festivali i kafes” organizuar nga OJQ CBM, financuar nga USAID dhe bashkë financuar nga Komuna e Mitrovicës, Festivali Tradicional i Komedisë – me organizatorë: Mitrix NGO, Mitrovica Guitar Days - Organizator: KosovaArs NGO, aktivitetet për festat e 28 Nëntorit etj. Pastaj ka qenë edhe një hapje e thirrjes për përkrahje të projekteve kulturore - artistike për OJQ-të (vendimi: 21 tetor, publikimi: 24 tetor).

23 Shkolla e Muzikës të ketë objektin e saj STATUSI:  Aspak

24 Muzeu i Qytetit të ketë objektin e saj STATUSI:  Aspak



Inspektorat

25 Ndalim i ndotjes akustike në qendër

STATUSI: Pjesërisht

Janë shqiptuar 4 gjoba për ndotje të mjedisit dhe disa vërejtje verbale për hedhje të mbeturinave në hapësira publike, jashtë vendeve adekuate.

26 Ndalimi i keqpërdorimit të ujit të pijshëm

STATUSI: Pjesërisht

Kompania Rajonale e Ujësjellësit, bënë thirrje për shlyerje borxhesh ndaj kompanisë nga ana e konsumatorëve dhe ka nxjerrë vendim për procedim tek përmbartuesi privat.

27 Rritje të numrit të inspektorëve.

STATUSI: Aspak



Shërbime Publike

28 Eliminimi i mbeturinave tek shkolla “Eqrem Qabej” dhe Shkolla e Mjekësisë “Dr. Xheladin Dedë”

STATUSI: Aspak

29 Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave

STATUSI: Aspak



Siguri

30 Vendosja e akustikës në semaforët për sinjalizim të personave të verbër

STATUSI: Aspak

31 Trajtimi i qenëve endacak në rrugë dhe krijimi i qendrave për kujdesin e kafshëve

STATUSI: Aspak



Arsim

32 Ndarja e bursave për studentët pa vonesa

STATUSI:  Plotësisht

Ndarja e 180 bursave për studentët e vitit akademik 2022/23, ku 10 prej tyre u takojnë komuniteteve dhe 50 prej tyre për nxënës të shkollës së mesme teknike “Arkitekt Sinani”.



Sport

33 Ndarja e bursave për studentët pa vonesa

STATUSI:  Aspak

Funksionalizimi i “Omni Sport” dhe ofrimi i qasjes për personat me aftësi të kufizuara



 Plotësisht

 Pjesërisht

 Aspak

Në Komunën e Mitrovicës Veriore janë organizuar tri diskutime me qytetarë. Në debatin e parë është diskutuar për problemet e përgjithshme, në të dytin për siguria e qytetarëve, dhe në të tretin për dialogun social për punë të dinjitetshme për gra, burra dhe rini në nivel lokal. Në këto tri diskutime kanë marrë pjesë gjithsej 30 qytetarë, prej të cilëve 50% kanë qenë gra, dhe 50% kanë qenë burra.

Nga tri diskutimet, qytetarët kanë ngritur 27 prioritetet të cilat, sipas tyre, duhet të adresohen nga qeverisja e ardhshme lokale. Kryetari, është zotuar për të gjitha nga këto prioritete.

Çështjet që i kanë ngritur qytetarët janë të fushës së sigurisë, infrastrukturës, ambientit dhe të tjera si më poshtë:



Siguri

- 1** **Patrullim i përhershëm i policisë në hyrje të qytetit, nga drejtimi i Zveçanit** STATUSI: Plotësisht

Njësitë patrulluese shfaqen më shpesh në seksionin e treguar rrugor.

- 2** **Rritja e pranisë së njërive policore në pikat kritike në lagjen Mahalla e Boshnjakëve dhe në afërsi të urës kryesore** STATUSI: Pjesërisht

Numri i njërive patrulluese dhe frekuenca e patrullimit është rritur pjesërisht në pjesët e caktuara të komunës.

- 3** **Zgjidhja e problemit të qenëve endacak** STATUSI: Aspak

Numri i qenëve endacakë nuk ka rënë dhe vazhdon të jetë problem i përditshëm për qytetarët.

- 4** **Përmirësimi i sigurisë në qarkullim rrugor** STATUSI: Aspak

Siguria në komunikacion mbetet ende një nga problemet kritike në Mitrovicën e Veriut. Komuna nuk ka ofruar ende një zgjidhje afatshkurtër apo afatgjatë, përveç njoftimeve të përgjithshme për rregullim dhe kontroll më të mirë të trafikut.

- 5** **Zgjidhje urgjente për problemin e mbajtjes së armëve të ftohta nga një numër i caktuar të rinjsh, veçanërisht kur dalin për argëtim** STATUSI: Aspak

Nuk ka përparim në zgjidhjen e këtij problemi.

- 6** **Përdorimi më i madh i kamerave për të gjetur dhe identifikuar personat që kanë kryer vepër penale** STATUSI: Aspak

Sipas pohimeve të burimeve relevante nga komuna, Mitrovica e Veriut është e mbuluar nga një numër i mjaftueshëm i kamerave.

Infrastrukturë

7 Rregullimi i fasadave në ndërtesat më të vjetra STATUSI: Plotësisht

Fasadat e objekteve për të cilat Komuna ka parashikuar rivitalizimin janë ndryshuar.

8 Rregullimi urban dhe planifikimi i hapësirave publike STATUSI: Pjesërisht

Kuvendi Komunal i Mitrovicës Veriore ka hartuar një plan për rregullimin e hapësirave publike, por ende është duke u zbatuar ngadalë.

9 Zgjerimi i shtigjeve ekzistuese të këmbësorëve STATUSI: Pjesërisht

Po punohet për zgjerimin e shtigjeve të këmbësorëve në një sërë rrugësh më të ngarkuara.

10 Zëvendësimi i gypave të kanalizimit në ndërtesat e vjetra STATUSI: Pjesërisht

Në disa objekte ku tubat e kanalizimeve shkaktuan probleme teknike, problemi është zgjidhur.

11 Ndiriçimi i të gjitha rrugëve në qytet STATUSI: Pjesërisht

Një sërë rrugësh që më parë nuk kishin ndriçim iu dha ndriçimi i ri rrugor LED.

Ambient

12 Ndërtimi i një numri më të madh të sipërfaqeve të gjelbra për rekreacion në natyrë STATUSI: Aspak

Sasia e sipërfaqeve të gjelbra nuk është rritur.

13 Rregullimi i bregut përgjatë lumit Ibër STATUSI: Aspak

Bregu i lumit Ibër në anën e komunës së Mitrovicës Veriore nuk është i rregulluar. Ndërkohë, situata u përkeqësua, pasi pemët dhe bimësia përgjatë bregdetit u rritën në mënyrë të pakontrolluar.



Ambient

14

Përmirësimi i shërbimeve për mbledhje të mbeturinave

STATUSI: Aspak

Cilësia e ofrimit të shërbimeve komunale ka mbetur në të njëjtin nivel, pa progres pozitiv.

15

Largimi i deponive ilegale të mbeturinave

STATUSI: Aspak

Asnjë nga deponitë ilegale nuk është rregulluar.



Sociale

16

Sigurimi i qasjes së barabartë dhe transparente në punësim për të rinjtë

STATUSI: Aspak

Në periudhën që pasoi zgjedhjet, nuk u prezantua asnjë praktikë dhe nuk u diskutua për një qasje transparente ndaj punësimit të të rinjve.

17

Largimi i pengesave fizike për lëvizjen e lirë të personave me aftësi të kufizuara, si dhe prindërve me fëmijë

STATUSI: Aspak

Kjo çështje nuk është diskutuar në Kuvendin e Komunës dhe nuk është bërë diçka në praktikë.

18

Raportimi dhe legalizimi i punës së kompanive private me qëllim të përmirësimit të kushteve të punës të punëtorëve

STATUSI: Aspak

Nuk ka përparim në zgjidhjen e kësaj çështje.

19

Respektimi i kuotave për punësim të grave dhe përfaqësuesve të grupeve të marginalizuara

STATUSI: Aspak

Gjatë periudhës së monitorimit nuk është vërejtur progres në zgjidhjen e këtij problemi.



Administratë

20 Punësimi i përhershëm i personelit në Stacionin e Autobusëve STATUSI: Aspak

Stafi që do të punësohej përgjithmonë në Stacionin Kryesor të Autobusëve ende nuk është punësuar.

21 Parandalimi i presionit politik mbi punëtorët e institucioneve dhe kompanive publike STATUSI: Aspak

Pa progres të dukshëm në zgjidhjen e këtij problemi.

22 Rritja e transparencës në institucionet publike STATUSI: Aspak

As kuvendi i komunës, as kryetari, nuk kanë komentuar për këtë problem, kështu që nuk është nisur diskutimi publik.



Inspektorat

23 Përmirësimi dhe kontrolli i kushteve të punës për punëtorët në skele STATUSI: Aspak

Nuk ka përparim në zgjidhjen e kësaj çështje.

24 Monitorimi i respektimit të të drejtave të punëtorëve në sektorin privat, në fokus të grave STATUSI: Aspak

Komuna deri më tani nuk ka nisur një debat publik dhe as nuk është marrë me këtë problem në praktikë.



Shëndetësi

25 Përmirësimi i kushteve higjienike në Qendrën Klinike Spitalore STATUSI: Aspak

Kushtet higjienike në QKS nuk janë përmirësuar ende.



Kulturë

26 Ndërtimi i një qendre kulturore për të rinjtë

STATUSI:  Pjesërisht

Procesi i ndërtimit të një qendre kulturore dhe rinore ka nisur, por për momentin nuk ka punë të mëtejshme.



 Plotësisht

 Pjesërisht

 Aspak

Në takimet me qytetarët e Komunës së Obiliqit është diskutuar për problemet e përgjithshme, dhe për Dialogun social për punë të dinjitetshme për gra, burra dhe rini në nivel lokal. Në këto diskutime kanë marrë pjesë gjithsej 59 qytetarë, prej të cilëve 34% kanë qenë gra, dhe 66% kanë qenë burra.

Qytetarët kanë listuar 28 prioritete, për të cilat Kryetari Xhafer Gashi, u zotua se do t'i përbushë të gjitha gjatë mandatit të tij 4 vjeçar. Prioritetet përfshijnë çështje të fushës sociale, infrastrukture, administrative dhe të tjera.



Çështjet që i kanë ngritur qytetarët janë të fushës së arsimit, infrastrukturës, administratës dhe të tjera si më poshtë:



Sociale

1 Organizimi i takimeve në mes të komunës dhe përfaqësuesve të fshatrave STATUSI: Plotësisht

Kanë filluar të merren parasysh kërkesat e qytetarëve, tash kështu po veprohet. Gjatë mbajtjes së tre takimeve me qytetarët e Komunës së Obiliqit ndër prioritete që kanë dalur, ka qenë edhe ky për organizimin e takimeve në mes komunës dhe përfaqësuesve të fshatrave, ku qytetarët gjatë takimit kanë kërkuar që çdo herë kur Komuna e Obiliqit vendos të mbajë takime me qytetarë, ata të informohen me kohë 2-3 ditë më herët, dhe gjithashtu të caktohet koha dhe vendi i përshtatshme për banorët, që të mund të marrin pjesë në takim.

2 Rritja e punësimit të grave STATUSI: Plotësisht

Më shumë ka të punësuar gra se meshkuj në administratën publike, arsim dhe shëndetësi. Në institucionet e qeverisjes lokale, Arsim, Administratë, Shëndetësi, ka më shumë të punësuar gra, rritja e numrit të punësuarve gra është arritur gradualisht të qeverisjes nga dy mandatet e kaluara dhe të tanishëm të Kryetarit.

3 Buxhetim të përgjegjshëm gjinor STATUSI: Plotësisht

Buxhetimi gjinor bëhet në bazë të Kornizës Afatmesme Buxhetore –KAB dhe Buxhetit komunal. Sa i përket kësaj Komuna e Obiliqit qëndron mirë me buxhetimin gjinor, sepse përkrahë projekte të ndryshme që kanë për qëllim nxitjen dhe avancimin e rolit të gruas në zhvillimin ekonomik, duke përkahur gratë në biznes, në bujqësi.

4 Nxitja e qytetarëve për të marrë pjesë në dëgjimet buxhetore STATUSI: Pjesërisht

Është themeluar komisioni dhe janë partnerë Komuna e Obiliqit me USAID kontrata sociale.



Sociale

5 Rritja e numrit të projekteve për rini STATUSI: Pjesërisht

Janë me plan të punës dhe realizohet te gjitha. Drejtoria e Kulturës në Obiliq ka planin e punës në bazë të cilit vepron për një vit të tërë kalendarik . Në bazë të këtij plani realizon projektet. Realizimi i projekteve bëhet në bazë të planifikimeve, në data të caktuara.

6 Përmirësimi i infrastrukturës për personat me nevoja të veçanta STATUSI: Pjesërisht

Në të gjitha objektet publike, parqet, trotuaret dhe rrugët kryesore kanë qasje personat me nevoja të veçanta, rrugët tjera në fshatra duhet pasur qasje për personat me nevoja të veçanta, megjithatë rrugët në fshatra janë të asfaltuara.

7 Ofrimi i qasjes për personat me aftësi të kufizuara në fshatin Lajthishtë dhe Hamidi STATUSI: Pjesërisht

Në të gjitha objektet publike, parqet, trotuaret dhe rrugët kryesore kanë qasje personat me nevoja të veçanta, rrugët tjera në fshatra duhet pasur qasje për personat me nevoja të veçanta, megjithatë rrugët në fshatra janë të asfaltuara.

8 Rritja e punësimit të personave me aftësi të kufizuara. STATUSI: Pjesërisht

Ende nuk ka filluar punësimi i personave me nevoja te veçanta. Megjithatë, Komuna e Obiliqit përmes Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies sociale ndanë për çdo vit një shumë buxhetore prej 5,500 Euro për zyrën e Handikos në Obiliq. Në zyre është i punësuar një përgjegjës i zyrës i cili merret me identifikimin e personave dhe aftësi të veçanta, gjithashtu dhe në ofrimin e shërbimeve për këta persona si dhënie në shfrytëzim për pajisje që ju nevojiten këtyre personave karroca, gjëra higjienike, paterica etj.

9 Promovimi i të drejtave të punëtorëve në sektorin privat STATUSI: Aspak

Duke analizuar kompetencat e nivelit lokal lidhur me promovimin e të drejtave të punëtorëve në sektorin privat, këtu mund të themi se politikat e nivelit lokal Komuna ka për obligim që të ofrojë kushte për investitorë, por njëherit edhe ti nxisë që investojnë në Komunën e Obiliqit. Komuna ka përcaktuar zonën industriale në fshatin Lazarevë. Komuna në këtë aspekt ka bërë disa lëvizje para sikurse përcaktimi i lokacionit për zonën industriale.



Infrastrukturë

10

Rregullimi i kanalizimit në rrugën “Idriz Sallova”

STATUSI: Plotësisht

Komuna e Obiliqit sa i përket investimeve në zhvillimin e infrastrukturës qëndron mirë, ngase shumica e rrugëve në qytet dhe në fshatra janë të asfaltuara, por njëherit edhe me aspektet përcjellëse, kanalizim, ujësjellës, ndriçim publik, këtë ja ka mundësuar buxheti i ndarë nga Ligji për Obiliqin. Sa i përket çështjes së ngritur nga takimi me qytetarë, ka qenë një shtëpi në lagje e cila është ndërtuar më vonë, dhe pronari i shtëpisë ka marrë pjesë në takim dhe e ka ngritur si shqetësim se shtëpia e tij nuk ka qenë e kyçur në kanalizim, dhe komuna ja ka mundësuar që të kyqet në kanalizim, ngase kyqja kryesore ka qenë në një distancë të largët.

11

Rregullimi i trajtimit të ujërave të zeza – kanalizimit në 4 lagje të fshatit Breznicë, Lagja Kosokovik, Përveticë dhe Syla

STATUSI: Plotësisht

Janë në procedurë të prokurimit. Kjo çështje ka përfunduar në këto lagje në fshatin Breznicë, e kam cekur edhe në raportin mujor që e kam dërguar. Ky prioritet është rregulluar.

12

Zgjerimi i rrugëve nëpër lagjet e qytetit

STATUSI: Pjesërisht

Rrugët janë të ndërtuara në lagje me pëlqim të banorëve aq sa e kanë lëshuar tokën e tyre.

13

Furnizimi me ngrohje qendrore

STATUSI: Pjesërisht

Komuna sa i përket kësaj çështje pas përfundimit të studimit të fizibilitetit, tash vetëm sa kanë vendosur gurthemelin për fillimin e projektit për Kogjenerim-shtrirja e rrjetit të sistemit të ngrohjes qendrore në qytet dhe fshatra. Projekti është paraparë të zgjasë 3 vite.

14

Shtrimi i trotuarit dhe rregullimi i fushës së sportit në fshatin Lajthishtë

STATUSI: Aspak

Janë të përfunduara të gjitha rrugët dhe fusha e sportit është riparuar, por mungon trotuari brenda fshatit dhe në rrugën kryesore që e lidh fshatin Lajthishtë me fshatin Palaj -(ish-Vodicë).

15

Riparimi i rrugës Hamidi-Siboc

STATUSI: Aspak

Është në procedurë të prokurimit për këtë vit.

Infrastrukturë

16 Shtrimi i trotuarit në rrugën Breznicë-Kozaricë STATUSI: Aspak

I planifikuar për vitin e ardhshëm.

Administratë

17 Zbatimi i Ligjit për Obiliqin STATUSI: Pjesërisht

Janë duke bërë përpjekje maksimale për zbatimin e ligjit për Obiliqin për punësim dhe për tarifa për qytetarët e Komunës së Obiliqit. Për këtë është bërë padi ne ZRRE nga Komuna e Obiliqit dhe është aprovuar nga Gjykata si e bazuar.

18 Rritja e punësimit të ekspertëve të rinj, me fokus në sektorin e mbrojtjes së mjedisit STATUSI: Pjesërisht

Sipas nevojës ku kërkohet dhe shqetësuese është edhe numri i limituar i punëtorëve në administratë. Komuna planifikon të hap konkurse për punësim, për ti angazhuar ekspertë të rinj, në sektorin e mbrojtjes së mjedisit. Këtë mundësi ja lejon edhe Ligji për Obiliqin.

19 Qartësim i statusit për regjistrim të pronave në fshatin Lajthishtë STATUSI: Pjesërisht

Është zonë me interes te veçantë e shpallur nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Drejtoria e Kadastrit dhe Pronës ka përgatitur Planin Zhvillimor Komunal, i cili është votuar në Kuvendin Komunal. Pas votimit është dërguar në Ministri të Administrimit të Pushtetit Lokal për vlerësimin e ligjshmërisë. Në momentin që vlerësohet ligjshmëria e vendimit, vazhdohet me hartimin e Hartave Zonale. Në bazë të PZHK-së banorët e fshatit Lajthishtë do të pajisen me leje ndërtimore, ngase edhe pse kjo zonë është zonë e interesit nacional, por KEK-u në këtë zonë deri ne vitin 2060 mendon të zgjerohet, por deri sa të vijë zgjerimi i KEK-ut banorët e fshatit do të pajisen me leje ndërtimore.

20 Digjitalizimi i shërbimeve komunale për qytetarë STATUSI: Aspak

Qytetarët në komunë në zyrën pritëse shërbehen me numra për pritje me rend, për ofrimin e shërbimeve komunale



Shëndetësi

21 Furnizimi me pajisje mbrojtëse në QKMF STATUSI: Plotësisht

Ka mjete te mjaftueshme mbrojtëse për staf.

22 Pagesa të vullnetarët e Kryqit të Kuq STATUSI: Plotësisht

Gjatë kohës së përhapjes së pandemisë COVID-19, vullnetarët e Kryqit të Kuq në Obiliq kanë ndihmuar qytetarët në qendrën e vaksinimit, ku i kanë orientuar qytetarët se te cila ekip mjekësore do të vaksinohen. Dhe për këtë ndihmesë ata janë stimuluar me një pagesë për ushqim dhe pije.



Arsim

23 Orët e mësimdhënësve të jenë të plota dhe të ketë ndarje meritore STATUSI: Plotësisht

Të gjitha janë sipas normës dhe kërkesave.

24 Përfshirja e psikologëve në shkolla STATUSI: Aspak

Është në proces 2-4 psikolog dhe sociolog.




Transport

25 Ofrimi i transportit publik nëpër fshatra STATUSI: Pjesërisht

Mungon vetëm në 2-3 fshatra, Komuna e Obiliqit Drejtoria e Shërbimeve Publike është në proces të riorganizim të ri dhe marrëveshje të re me Komunën e Prishtinës.



Ekonomi

- 26** **Rritja e bashkëpunimit të komunës me bizneset për të inkurajuar ofrimin e programeve të praktikës me pagesë** STATUSI:  Pjesërisht

Komuna e Obiliqit ka pasur dy projekte me Ministrinë dhe Komuna e Obiliqit i paguan simbolikisht praktikantët.



Bujqësi

- 27** **Rritja e investimeve në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë** STATUSI:  Plotësisht

Komuna e Obiliqit i përkrahë të gjitha sektorët e bujqësisë dhe për këtë vit dhe vitin e ardhshëm janë paraparë mbi 10 mini ferma deri në 5 krahë lopë që kanë me u shpërnda.



Inspektorat

- 28** **Zbatimi i kontratave të punës dhe respektimi i Ligjit të Punës për punëtorët në sektorin privat** STATUSI:  Pjesërisht

Përgjegjësi e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale; Inspektorët e punës.



 Plotësisht

 Pjesërisht

 Aspak

Në Komunën e Pejës gjatë fushatës zgjedhore, janë organizuar tri diskutime me qytetarë. Në debatin e parë është diskutuar për problemet e përgjithshme, në të dytin për sfidat dhe prioritetet për zhvillim të turizmit në Komunën e Pejës, ndërsa në të tretin për dialogun social për punë të dinjitetshme për gra, burra dhe rini në nivel lokal. Në këto tri diskutime kanë marrë pjesë gjithsej 34 qytetarë, prej të cilëve 53% kanë qenë gra, dhe 47% kanë qenë burra.

Gjatë këtyre diskutimeve, qytetarët kanë ngritur 27 prioritetet, të cilat sipas tyre duhet të përmbushen nga qeverisja e ardhshme lokale. Gazmend Muhaxheri, atëherë si kandidat, e tani si kryetar i Komunës së Pejës, është zotuar se do të përmbushë 14 prej tyre. Zotimet përfshijnë fushën e infrastrukturës, sociale, turizëm e të tjera.

Më poshtë do të analizohet veç e veç secili zotim, në kategori të ndara në bazë të fushës së prioritetëve.



Çështjet që i kanë ngritur qytetarët janë të fushës së infrastrukturës, ambientit, turizimit dhe të tjera si më poshtë:



Infrastrukturë

1 **Kyçja në kanalizim të qytetit të lagjes 7 Shtatori** STATUSI: Pjesërisht

Sa i përket kyçjes në kanalizim në këtë pjesë të qytetit, shumica e lagjeve kanë përfunduar. Pra rreth 80% lagje tashmë janë të kyçura.

2 **Sinjalizimi horizontal për çiklistët** STATUSI: Pjesërisht

Sinjalizimi horizontal për çiklistët është në proces ende, pra nuk ka përfunduar, megjithatë, vlenë të theksohet që disa sinjalizime në zona të caktuara kanë përfunduar, pra rreth 40% të sinjalizimeve kanë përfunduar.

3 **Rregullimi i ujësjellësit në regjionin e Rugovës** STATUSI: Pjesërisht

Komuna ka pasur pengesa për sigurimin e lejes nga Ministria e Infrastrukturës dhe Planifikimit Hapësinor, kurse tash janë siguruar lejet si dhe janë përgatitur procedurat e tenderimit, dhe besojmë që vitin tjetër do të përfundojnë në fshatrat: Stanka, Bogë, Shkrel, Dugaivë, Pepaj dhe Kuçishtë.

4 **Trajtimi i kanalit të hapur te Shkolla Fillore “Xhemajl Kada”** STATUSI: Aspak

Për këtë zotim, duke u bazuar në monitorimin e seancave komunale, janë paraparë 200,000.00 euro në planifikimet buxhetore komunale për vitin 2023. Rrjedhimisht, ende nuk është ndërmarrë diçka konkrete, por që pritet të realizohet gjatë vitit të ardhshëm.



Sociale

5 Hapja e një kopshti të ri për fëmijët STATUSI: Pjesërisht

Është në prag të përfundimit, dhe në vitin 2023, pra rreth muajit shkurt pretendohet të hapet kopshti në Karagaç.

6 Nxitja e punësimit të rinjve përmes projekteve inovative, orientimit të hershëm në karrierë, dhe zhvillimi të shkathtësive të kërkuara në tregun e punës STATUSI: Pjesërisht

Kjo qasje është duke u aplikuar në shkollën profesionale për aftësim, pra në shkollën teknike dhe në shkollën e birovit.

7 Hapjen e çerdheve të reja për fëmijët STATUSI: Pjesërisht

Dy janë në punim e sipër: njëra në fshatin Vitomericë, dhe tjetra në oborrin e shkollës ekonomike ka ngelur e pakryer për shkak se operatorit ekonomik i është ndërprerë kontrata me arsyetimin që nuk ka punuar, dhe duhet të fillojmë procedurën e re.



Ambient

8 Rregullimi i hapësirave publike të banesat e lagjes Fidanishte STATUSI: Pjesërisht

Qytetarët gjatë diskutimeve, kanë kërkuar ri-modelimin e rrugëve prej rrethit tek Rokaqielli deri tek rrethi i Vitomericës dhe shndërrimi i këtyre rrugëve në bulevard. Në planifikimet buxhetore, janë paraparë 500,000.00 euro për vitin 2024. Kjo pjesë e cekur në buxhetin komunal e përfshin edhe zonën e Fidanishtes e qe njëherit është kërkesë e qytetarëve dhe zotim i kryetarit.



Turizëm

9

Fuqizimi i Zyrës Turistike në Pejë

STATUSI:  Pjesërisht

Tek Zyra e Turizmit në Pejë është investuar mjaftueshëm.

10

Krijimi i këndit për shitje të syvenirëve në Muzeun e Qytetit

STATUSI:  Pjesërisht

Sipas informacionet të fundit, këndi tashmë është krijuar.



Shëndetësi

11

Hapja e Labororit në QKMF për realizimin e analizave laboratorike të përgjithshme

STATUSI:  Plotësisht

Ky laborator tashmë është funksional.



Inspektorat

12

Largimi i shitësve ilegal të drunjëve dhe kafshëve në lagjen 7 Shtatori

STATUSI:  Aspak

Nuk kemi arritur ta zgjedhim këtë çështje, sepse kemi pasur mungesë të inspektorëve.



Administratë

13

Digjitalizimi i shërbimeve komunale për qytetarët

STATUSI:  Pjesërisht

Në Komunën e Pejës digjitalizimi është në pjesën me të madhe, shërbimet ofrohen në formë elektronike, funksionojnë përmes shërbimeve që ofrohen nga niveli qendror një pjesë, dhe disa nga niveli lokal, niveli lokal ka krijuar baza të dhënave ku përmes tyre ju ofrohen shërbime qytetarëve.

Funksionon edhe e-kiosku i cili lëshon dokumente nga Gjendja Civile, shumë shpejt parashikohet që të ofrohet edhe shërbimi për nxjerrjen e certifikatave të pronës përmes e-kioskut më së largu deri me datë 10.01.2023.



Shërbime Publike

14

Rregullimi i rrjetit elektrik në regjionin e Rugovës

STATUSI:  Pjesërisht

Sivjet kanë përfunduar rreth 40% të punimeve, kurse vitin tjetër do të vazhdojnë punimet në rrjetin primar të tensionit të lartë.



 Plotësisht

 Pjesërisht

 Aspak

Në takimet me qytetarët e Komunës së Prizrenit është diskutuar për problemet e përgjithshme, hapësirat publike, dhe për dialogun social për punë të dinjitetshme për gra, burra dhe rini në nivel lokal. Në këto tri diskutime kanë marrë pjesë gjithsej 45 qytetarë, prej të cilëve 36% kanë qenë gra, dhe 64% kanë qenë burra.

Qytetarët kanë ngritur 31 prioritetet të cilat, sipas tyre, duhet të adresohen nga qeverisja e ardhshme lokale. Këto prioritete kryesisht janë të fushës sociale, infrastrukturore, administrative e të tjera. Kandidati i atëhershëm e tani Kryetari i kësaj komune, është zotuar për 28 prej tyre. Në vijim do të paraqiten prioritetet të ndara në secilën fushë dhe statusi i tyre sa i përket përmbushjes nga ana e komunës.



Çështjet që i kanë ngritur qytetarët janë të fushës së inspektoratit, infrastrukturës, urbanizimit dhe të tjera si më poshtë:



Sociale

1 Zgjidhja e problemit të qenëve endacak STATUSI: Pjesërisht

Komuna e Prizrenit ka pasur kontratë aktive deri në maj të vitit 2021 për trajtimin duke përfshirë sterilizimin, vaksinimin dhe matrikulimin. Sa i përket trajtimit të qenëve endacak, sipas kontratës ka qenë e parashikuar të trajtohen 1000 mijë qenë endacak.

2 Ofrimi i qasjes për lëvizje të lirë në rrugë për personat me aftësi të kufizuara STATUSI: Pjesërisht

Personat me aftësi të kufizuara ballafaqohen secilën ditë me barrierat fizike duke filluar nga trotualet e ngushta, vendkalimet jo adekuate për këmbësorë, qasje e kufizuar në objekte publike dhe barrierat tjera. Sa i përket qasjes së personave me aftësi të kufizuara, në komunë është e rregulluar në mandatin e qeverisjes së kaluar me rregullimin e “One Stop Shop”, së fundmi kanë filluar punimet në rregullimin e rrugës unazore ku komuna do të vendosë pllaka për personat e verbër si dhe do të vendosë pjerrina që do të lehtësojë qasjen e tyre në institucione.

3 Organizimi i aktiviteteve për edukimin e të rinjve STATUSI: Pjesërisht

Komuna e Prizrenit ndanë subvencione në baza vjetore për kulturë, rini dhe sport.

4 Rritja e inspektimeve për respektimin e të drejtave të punëtorëve në sektorin privat dhe publik STATUSI: Pjesërisht

Bëhen kontrollime të rregullta por numri i inspektorëve mbetet i vogël.

5 Subvencionimi i bizneseve që aftësojnë dhe punësojnë të rinj STATUSI: Pjesërisht

Fondi për mbështetjen e start-up bizneseve planifikohet të formohet, brenda kornizave ligjore. Grante me donatorë, janë dhënë.



Sociale

- 6 Hartimi i Planit Strategjik për Aftësimin e të Rinjve** STATUSI:  Aspak

Nuk është realizuar.

- 7 Hartimi i Rregullores për Vullnetarizëm** STATUSI:  Aspak

Nuk është realizuar.

- 8 Garantimi dhe mbrojtja e të drejtave të punës të komuniteteve jo shumicë** STATUSI:  Aspak

Nuk është realizuar. Të drejtat e tyre janë të garantuara me Kushtetutë dhe me ligje të ndryshme.

- 9 Krijimi i Qendrës profesionale për orientim në karrierë** STATUSI:  Aspak

Nuk është realizuar.

- 10 Zhvillimi i kampanjave për vetëdijesimin e qytetarëve për të drejtat e punës** STATUSI:  Aspak

Nuk është realizuar.



Infrastrukturë

- 11 Furnizimi i rregullt me ujë të pijshëm** STATUSI:  Pjesërisht

Komuna ka filluar procedurat për fizibilitetin e projektit për sigurimin e ujit të pijes 24 orë. Është nënshkruar marrëveshja me Hidroregjionin Jugor dhe po bëhen përgatitjet për projektin.



Infrastrukturë

12 Funksionalizimi i semaforëve

STATUSI: Pjesërisht

Shumica e semaforëve janë funksional por në buxhetin e vitit 2023 janë parashikuar intervenime dhe riparime në sinjalistikën e Komunës së Prizrenit.

13 Ofrimi i ndriçimit publik

STATUSI: Pjesërisht

Ndriçimi publik nuk është funksional në të gjitha lokalitetet.

14 Rregullimi i ndriçimit publik nëpër lagje

STATUSI: Pjesërisht

Ndriçimi publik nuk është funksional në të gjitha lokalitetet.

15 Përmirësimi i infrastrukturës rrugore

STATUSI: Pjesërisht

Në mahalla.info janë duke u paraqitur rregullisht rastet të ndryshme për problemet infrastrukturore në Komunën e Prizrenit.

16 Krijimi i tregut dhe parkut në Lagjen Dardani

STATUSI: Aspak



Administratë


17 Eliminimi i burokracisë në komunë

STATUSI: Pjesërisht

Pas funksionalizimit të “One stop shop” është bërë lehtësimi për sigurim të dokumenteve.



Administratë

- 18** **Digjitalizimi i shërbimeve komunale për qytetarë** STATUSI:  Pjesërisht


Disa nga shërbimet si: certifikata e lindjes, certifikata e martesës etj. qytetarët kanë mundësi t'i sigurojnë përmes e – Kosova.

- 19** **Hartimi i Planit strategjik për menaxhimin e burimeve njerëzore** STATUSI:  Aspak


Nuk është realizuar.



Inspektorat

- 20** **Ndalimi i shfrytëzimit të trotuareve si parkingje të veturave** STATUSI:  Pjesërisht

Parkimi dhe uzurpimi i trotuareve mbetet problem për lëvizje të lirë të këmbësorëve në bazë të raportimeve të shumta në mahalla.info.

- 21** **Ndalimi i dëmtimit të shtratit të lumit nga intervenimet me mjete të rënda** STATUSI:  Pjesërisht

Në mahalla.info janë paraqitur rastet e derdhjes së ujërave të zeza dhe gjuajtjes së dheut gjatë gërmimeve për ndërtimin e banesave, por raste kur është intervenuar direkt në shtratin e lumit nuk është raportuar.

- 22** **Mbrojtja dhe kontrollimi i zonave historike** STATUSI:  Pjesërisht

Bëhen kontrollime të rregullta të këtyre zonave por numri i inspektorëve mbetet i vogël.



Urbanizëm

23 Emërimet e të gjitha rrugëve

STATUSI:  Pjesërisht

Shumica e rrugëve kanë emërtime. Ne buxhetin e vitit 2023 janë paraparë intervenime dhe riparime në sinjalistikën e Komunës së Prizrenit.

24 Zgjidhja e problemit të trafikut të dendur

STATUSI:  Aspak

Gjatë sezonit të verës trafiku mbetet i dendur. Ndërsa për ndërtimin e parkingjeve të reja komuna është në fazën e identifikimit të hapësirave publike.

25 Hartimi i planit të mobilitetit për zonën e parë historike

STATUSI:  Aspak

Shërbime Publike

26 Hartimi i Planit për menaxhimin e mbeturinave

STATUSI:  Pjesërisht

Menaxhimi i mbeturinave në komunën e Prizrenit realizohet nga Eko-Regjioni.

27 Mirëmbajtja dhe shtimi i hapësirave të reja të gjelbra

STATUSI:  Pjesërisht

Komuna dhe organizatat të ndryshme investojnë në shtimin e hapësirave të reja të reja të gjelbërta por mirëmbajtja e tyre nuk bëhet në mënyrë adekuate nga ana e kompanive të kontraktuara nga komuna.




Turizëm

28 Krijimi i hapësirës për promovim të shitjes së punëve artizanale

STATUSI:  Pjesërisht

Në korrik të vitit 2020, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik ka hapur Qendrën e Kurseve Artizanale. Por nuk ekziston vend ku mund të i shesin punimet e tyre dhe ti ekspozojnë.



 Plotësisht

 Pjesërisht

 Aspak

Në takimet me qytetarët e Komunës së Skenderajt, është diskutuar për problemet e përgjithshme, për infrastrukturën në zonat rurale, dhe për Dialogun social për punë të dinjitetshme për gra, burra dhe rini në nivel lokal. Në këto tri diskutime kanë marrë pjesë gjithsej 37 qytetarë, prej të cilëve 38% kanë qenë gra, dhe 62% kanë qenë burra.

Nga këto takime, qytetarët kanë ngritur 21 prioritete, prej të cilave, kryetari i tanishëm Fadil Nura, nga Partia Demokratike e Kosovës, është zotuar për 19 prej tyre.



Çështjet që i kanë ngritur qytetarët janë të fushës së infrastrukturës, arsimit dhe administratës dhe të tjera si më poshtë:



Sociale

- 1** **Ndërtimi i Qendrës rehabilituese për personat me aftësi të kufizuara** STATUSI: Plotësisht

Ka përfunduar ndërtimi i qendrës. Në këtë qendër, kryen aktivitetin në baza ditore Shoqata Handikos në Skenderaj, ku zhvillohen takimet e përditshme, si dhe aktualisht ipen shërbime psikologjike dhe fizioterapeutike nga Qendra Kosovare për Vetëpërkrahje, me financim nga Save the Children.

- 2** **Përkrahje e personave me aftësi të kufizuara në ndërmarrësi** STATUSI: Pjesërisht

Komuna ka ndarë disa minigrante. Gjatë këtij viti komuna ka qenë bashkëfinancues me BE-në, për ndarjen e granteve të vogla për mbështetjen e start-up bizneseve për personat me aftësi të kufizuara, ku disa nga ndërmarrjet që janë hapur janë: sallon estetike, kompani pastrimi, dyqan me veshje tradicionale etj.

- 3** **Subvencionimi dhe mbështetja e bizneseve private, me theks të veçantë ato në pronësi të grave** STATUSI: Pjesërisht

Përmes grantit në bashkëpunim me skemën Komunat për të rinjtë, komuna ka mbështetur me 15% 3 bizneseve të inicuar nga vajzat e reja, të cilat janë në hapje e sipër. Këto biznese kanë fokus trajnimitin e vajzave dhe grave në fushën e rrobaqepësisë. Po ashtu përmes bashkëpunimit me organizatën Help Kosova, janë mbështetur 8 biznese, ku 6 prej tyre janë të menaxhuara dhe udhëhequra nga gratë.

- 4** **Ndarja e fondeve për subvencionim të ndërmarrësve** STATUSI: Aspak

Deri më tani nuk ka ngritje të fondeve. Komuna e adreson problemin në nivel qendror pasi nuk ka pasur mbështetje nga ana e nivelit qendror.

- 5** **Ndërtimi i qendrave rinore në bashkësi lokale** STATUSI: Aspak

Nuk ka asnjë qendër rinore në fshatra. Kryetari, por edhe zyrtarët publik janë shprehur se ky zotim është bërë dhe mendohet të finalizohet brenda mandatit.



Infrastrukturë

6 Ndërtimi i infrastrukturës përcjellëse në rrugët rurale STATUSI: Pjesërisht

Tetë projekte janë në realizim. Zgjerimi Rezallë-Likofc, shtegu i ciklizmit në Likofc, poligonet sportive në Lubovec dhe Vajnikë, rrugë në lagjet ë Runikut, rrugë në Runikë, rrugë në Aqarevë dhe poligoni në lagjen Osaj-Klinë e Epërme.

7 Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit STATUSI: Pjesërisht

Ka filluar realizimi i projekteve në 6 fshatra. Kanalizimi në Makërma, Obri, Likofc qendër, Kopiliq i Ulët, Lagjja 6, Vajnik.

8 Ndërtimi i pjerrinave për qasje në objektet publike STATUSI: Aspak

Nuk është evidentuar ndonjë projekt.

9 Ofrimi i transportit publik ndërmjet zonave rurale dhe urbane STATUSI: Aspak

Përveç linjave private nuk ka transport publik në zonat rurale.




Arsim

10 Ndërtimi i trotuareve pranë shkollave STATUSI: Pjesërisht

Tri projekte janë në realizim e sipër. Ka nisur ndërtimi i trotuarit në fshatin Turiqefc, Kllodernicë, Klinë të Ulët, Polac, kurse ka përfunduar në Likofc. Brenda mandatit katërveçar është planifikuar ndërtimi i trotuareve në të gjitha fshatrat.



Arsim

11 **Ndërtimi i çerdheve publike** STATUSI:  Pjesërisht

Ka filluar ndërtimi i një çerdheje në qytet, në fshatra asnjë.

12 **Ofrimi i bursave për studentë të nivelit master dhe atyre që studiojnë jashtë vendit** STATUSI:  Pjesërisht


Ka ngritje të numrit të bursave dhe ngritje të shumës së përgjithshme.




Ambient

13 **Pastrimi i shtratit të lumenjve** STATUSI:  Pjesërisht

Për vitin e ardhshëm janë ndarë 1 milion euro dhe ka nisur pastrimi i Lumit “Klina”.

14 **Ofrimi i shërbimit për grumbullim të mbeturinave** STATUSI:  Pjesërisht


Është evidentuar ngritje e kapaciteteve të ndërmarrjes lokale “Eko Natyra”.

15 **Krijimi i një organi komunal për mbikëqyrjen e hapësirave të gjelbra që dalin si rezultat i projekteve dhe donacioneve** STATUSI:  Aspak


Nuk janë formuar komisione.



Administratë

- 16** Digjitalizimi i shërbimeve komunale për qytetarët STATUSI:  Pjesërisht

Është funksionalizuar aparati online për certifikata.

- 17** Krijimi i një komisioni/organi të veçantë për mbikëqyrjen e procesit të punësimit të mësimitdhënësve në shkollat fillore dhe ato të mesme STATUSI:  Aspak

Nuk ka ende komisione, si dhe ka ankesa në këtë proces.



Inspektorat

- 18** Lirimi i trotuareve STATUSI:  Pjesërisht

Në disa rrugë të qytetit janë liruar trotualet dhe janë duke u ndërtuar në katër bashkësi lokale.



Sport

- 19** Ndërtimi i poligoneve sportive në fshatra STATUSI:  Aspak

Nuk ka nisur ndërtimi i asnjë poligoni.

